

SKK 2 - PARAQITJA E PASQYRAVE FINANCIARE

Pg		
	STANDARDI KOMBËTAR I KONTABILITETIT 2 – PARAQITJA E PASQYRAVE FINANCIARE - I PËRMIRËSUAR	
	PËRMBAJTJA	Paragrafët
	OBJEKTIVAT DHE BAZAT E PËRGATITJES	1 – 2
	FUSHA E ZBATIMIT	3
	PËRKUFIZIMET KRYESORE	4
	Materialiteti	5-7
	PARAQITJA E VËRTETË DHE E DREJTË	8-19
	Pajtueshmëria me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit	9-12
	Parimi i Vijimësisë	13-15
	Qëndrueshmëria e Paraqitjes	16-18
	Informacion Krahasues	19
	PËRMBAJTJA E PASQYRAVE FINANCIARE DHE KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR PËRGATITJEN E TYRE	20-28
	PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	29-46
	Rregulla të Përgjithshme	29-34
	Formate të veçanta të pasqyrës së pozicionit financiar	35-36
	Dallimi mes zërave afatshkurtër dhe afatgjatë të aktiveve dhe detyrimeve	37-38
	Aktivët Afatshkurtra	39-40
	Detyrimet Afatshkurtra	41-45
	Kompensimi i Aktiveve dhe Detyrimeve (Njohja në shumën neto)	46
	PASQYRA E PERFORMANCËS	47-60
	Rregulla të Përgjithshme	47-50
	Kërkesat e zbatueshme	51–56
	Formate të veçanta të pasqyrës së performancës	57-58
	Kompensimi i të ardhurave dhe shpenzimeve (njohja në shumën neto)	59-60
	PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	61-82
	Fluksi i mjeteve monetare në monedhë të huaj	65-67
	Interesi dhe dividendët	68-70
	Tatimi mbi fitimin	71
	Aktivitetet e shfrytëzimit	72
	Raportimi i flukseve të mjeteve monetare nga aktivitetet e shfrytëzimit	73
	Metoda direkte	74
	Metoda indirekte	75
	Fluksi i mjeteve monetare nga aktiviteti investuese	76
	Fluksi i mjeteve monetare nga aktiviteti i financimit	77
	Raportimi i fluksit të mjeteve monetare nga aktivitetet investuese dhe financuese	78
	Transaksionet jomonetare	79-80
	Përbërësit e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të mjeteve monetare	81
	Shënime të tjera shpjeguese lidhur me mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare	82
	PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	83-85
	SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	86-94
	Struktura e shënimeve	87-88

	Dhënia e informacioneve shpjeguese për politikat kontabël	89
	Informacion në lidhje me burimet kryesore të pasigurisë së vlerësimit	90
	Shpjegime mbi palët e lidhura	91-94
	DATA DHE RREGULLAT E ZBATIMIT TË STANDARDEVE	95
	KRAHASIMI ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR PËR NVM-të (2009)	96
	OBJEKTIVAT DHE BAZAT E PËRGATITJES	
1.	Objektivi i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit 2, “Paraqitja e Pasqyrave Financiare” (SKK 2), miratuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe shpallur nga Ministria e Financës, është të japë konceptet dhe rregullat-bazë, për paraqitjen e informacionit financiar në pasqyrat financiare të hartuara në përputhje me standardet kombëtare të kontabilitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit bazohen në parimet e kontabilitetit dhe të raportimeve financiare të pranuar në shkallë ndërkombëtare, kërkesat e përgjithshme të të cilave përshkruhen në Ligjin nr. 9 228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” publikuar në prill 2004, i ndryshuar.	
2.	<p>Kërkesat e SKK 2 korrespondojnë me disa paragrafë specifike të SNRF për NVM-të. Standardi bazohet fillimisht në:</p> <p><u>-Seksioni 3 i SNRF për NVM-të – Paraqitja e Pasqyrave Financiare</u></p> <p><u>- Seksioni 4 i SNRF për NVM-të – Pasqyra e Pozicionit Financiar</u></p> <p><u>- Seksioni 5 i SNRF për NVM-të - Pasqyra e të Ardhurave Gjithpërfshirëse dhe Pasqyra e të Ardhurave</u></p> <p><u>- Seksioni 6 i SNRF për NVM-të - Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto dhe Pasqyra e të ardhurave dhe fitimeve të pashpërndara</u></p> <p><u>- Seksioni 7 i SNRF për NVM - Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare</u></p> <p><u>- Seksioni 8 i SNRF për NVM-të - Shënimet e pasqyrave financiare.</u></p> <p><u>Krahasimi i SKK 2 me SNRF për NVM-të paraqitet në paragrafin 99.</u></p> <p>Për rastet që nuk janë trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga SKK 2 ose ndonjë SKK tjetër, drejtuesit e njësisë ekonomike duhet që, me miratimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit (KKK) të aplikojnë politika të tilla që sigurojnë një pasqyrim të vërtetë e të besueshëm të pozicionit financiar, performancës financiare, ndryshimeve në pozicionin financiar dhe fluksit të mjeteve monetare të njësisë ekonomike, siç kërkohet në nenin 9 të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.</p>	
	FUSHA E ZBATIMIT	
3.	Kërkesat e SKK 2, <i>Paraqitja e pasqyrave financiare</i> , do të zbatohen në të gjitha pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.	
	PËRKUFIZIMET KRYESORE	
4.	<p>Më poshtë jepen përkufizimet e disa termave kryesore të përdorura në këtë standard.</p> <p><i>Pasqyra e Pozicionit Financiar</i> - Pasqyra financiare që paraqet marrdhënien e aktiveve, detyrimeve dhe kapitalit të një njësie ekonomike në një datë të caktuar (njohur më parë si <i>bilanci</i>).</p> <p><i>Pasqyra e Performancës</i> - është një nga pasqyrat financiare që tregojnë performancën ekonomike (të ardhurat, shpenzimet, fitimin/humbjen e vitit dhe të ardhurat gjithëpërfshirëse) të një njësie ekonomike gjatë një periudhe kontabël. Ky set është i përbërë nga dy pasqyra:</p> <p>* <i>Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve</i> - Pasqyra financiare që paraqet të gjithë zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura gjatë periudhës, me përjashtim të zërave të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.</p> <p>* <i>Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse</i> - Pasqyra financiare që paraqet fitim/humbja e vitit dhe të gjithë zërat e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse që sjellin ndryshime në kapital.</p> <p><i>Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto</i>- Pasqyra financiare që paraqet fitimin ose humbjen e vitit, zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të cilat ndikojnë direkt në kapital për periudhën, efektet e ndryshimeve në politikat kontabël, korrigjimet e gabimeve për periudhën si dhe vlerat e transaksioneve me kapitalin e vet.</p> <p><i>Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare</i>- Pasqyra financiare që paraqet informacion mbi ndryshimet në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare për periudhën, duke e paraqitur këtë informacion në tre pjesë: aktiviteti i shfrytëzimit, i investimit dhe i financimit.</p> <p><i>Shënimet shpjeguese</i>- Pasqyra financiare që paraqet informacion shtesë, përveç atij të paraqitur në pasqyrat e mësipërme.</p>	
	Materialiteti	

5.	Pasqyrat financiare do të përgatiten mbi bazën e konceptit të materialitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit nuk do të zbatohen për zërat jomateriale. Parimi i materialitetit përkufizohet dhe sqarohet në paragrafët 70 deri 76 të SKK 1 - <i>Kuadri i Përgjithshëm për Përgatitjen e Pasqyrave Financiare</i> .
6.	Konsiderohen materiale mosraportimet ose deklarimet e gabuara të zërave, nëse ato në mënyrë individuale ose kolektive mund të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e pasqyrave financiare. Materialiteti varet nga madhësia dhe natyra e mosveprimeve ose deklarimeve të gabuara të gjykuara në rrethanat aktuale. Madhësia ose natyra e zërit, ose një kombinim i të dyjave mund të jenë faktori përcaktues i materialitetit.
7.	Një njësi ekonomike duhet të paraqesë veçmas secilën klasë materiale të zërave të ngjashëm. Një njësi ekonomike duhet të paraqesë veçmas artikuj, të një natyre ose funksioni të ndryshëm, përveçse kur ata janë jomaterial.
	PARAQITJA E VËRTETË DHE E DREJTË
8.	Një paraqitje e vërtetë dhe e drejtë kërkon një regjistrim të besueshëm të efekteve të transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve të tjera në përputhje me përkufizimet dhe kriteret e njohjes së aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve të përcaktuara në SKK 1 – Kuadri i Përgjithshëm për Përgatitjen e Pasqyrave Financiare. Zbatimi i Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit SNRF për NVM-të, me dhënie informacionesh shpjeguese shtesë, kur është e nevojshme, supozohet të rezultojë në pasqyra financiare që arrijnë një paraqitje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të mjeteve monetare të njësisë ekonomike. Dhënia e informacionesh shpjeguese shtesë të përmendura më sipër është e nevojshme kur pajtueshmëria me kërkesat specifike në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit është e pamjaftueshme për të mundësuar përdoruesit të kuptojnë efektin e transaksioneve të veçanta, ngjarjeve dhe kushteve të tjera në pozicionin financiar dhe performancën financiare të njësisë ekonomike.
	Pajtueshmëria me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
.	Një njësi ekonomike, pasqyrat financiare të së cilës janë në përputhje me SKK-të duhet të japë në shënimet shpjeguese një deklaratë të qartë dhe pa rezerva të kësaj pajtueshmërie.
10.	Në rrethana jashtëzakonisht të rralla në të cilat drejtuesit e njësisë ekonomike konstatojnë se përputhshmëria me dispozita të caktuara të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit nuk bën të mundur paraqitjen e vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe flukseve të mjeteve monetare të një njësie, atëherë drejtuesit duhet të përgatisin pasqyrat financiare në bazë të kërkesës për një paraqitje të vërtetë dhe të drejtë siç kërkohej nga <i>Paragrafi 8 i SKK 1 - Kuadri i Përgjithshëm për Përgatitjen e Pasqyrave Financiare</i> .
11.	Kur një njësi ekonomike niset nga një kërkesë e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit në përputhje me paragrafin 10, ajo duhet të japë informacionin shpjegues në vijim: (a) se drejtimi ka arritur në përfundimin se pasqyrat financiare paraqesin besnikërisht pozicionin financiar, performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare të njësisë ekonomike; (b) se raportimi është në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, përjashtuar rastet kur ka devijuar nga ndonjë kërkesë e veçantë për të arritur një paraqitje të vërtetë e të drejtë; (c) Natyrën e devijimit, duke përfshirë trajtimin që Standardet Kombëtare të Kontabilitetit do të kërkonin, arsyen se pse trajtimi do të ishte kaq çorientues në rrethana të caktuara që do të binte ndesh me objektivin e pasqyrave financiare të përcaktuara në paragrafin 5 deri 12 të SKK 1 – <i>Kuadri i Përgjithshëm për Përgatitjen e Pasqyrave Financiare</i> , dhe trajtimi i zbatuar;
12.	Kur një njësi ekonomike devijon nga një kërkesë e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit në një periudhë të mëparshme, dhe ky devijim ndikon shumë e njohura në pasqyrat financiare të periudhës aktuale, njësi do të japë informacionet shpjeguese të përcaktuara në paragrafin 11(c).
	Parimi i Vijimësisë
13.	Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i një njësie ekonomike që përdor Standardet Kombëtare të Kontabilitetit duhet të bëjë një vlerësim të aftësisë së njësisë ekonomike për të vazhduar në vijimësi. Një njësi ekonomike është në vijimësi derisa drejtimi të ketë ndërmend të likuidojë njësinë ekonomike ose të ndërpresë operacionet, kur nuk ka ndonjë alternativë tjetër realiste por vetëm të veprojë në këtë mënyrë. Në vlerësimin nëse supozimi i vijimësisë është i përshtatshëm, drejtimi merr parasysh të gjitha informacionet në dispozicion në lidhje me të ardhmen, e cila nënkupton një periudhë, të paktën dymbëdhjetë muaj mbas datës së raportimit .
14.	Kur një njësi ekonomike nuk përgatit pasqyra financiare mbi baza vijimësie, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt, së bashku me bazën mbi të cilën ajo i përgatit pasqyrat financiare dhe arsyen pse njësi ekonomike nuk është konsideruar në vijimësi.
15.	Kur drejtuesit janë në dijeni, në kryerjen e vlerësimit të tyre, mbi pasiguritë materiale lidhur me ngjarjet ose kushtet që hedhin dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e njësisë ekonomike për të vazhduar në vijimësi, njësi ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese mbi këto pasiguri.
	Qëndrueshmëria e Paraqitjes
16.	Një njësi ekonomike do të ruajë paraqitjen dhe klasifikimin e zërave në pasqyrat financiare nga njëra periudhë në tjetrën

	<p>derisa :</p> <p>(a) të jetë evidente, që pas një ndryshimi të rëndësishëm në natyrën e operacioneve të njësive ekonomike ose rishikimin e pasqyrave të saj financiare, një tjetër paraqitje apo klasifikim do të konsiderohej më i përshtatshëm duke u nisur nga kriteret për përzgjedhjen dhe zbatimin e politikave kontabël në Paragrafët 91 deri 97 të SKK 1 1 - <i>Kuadri i Përgjithshëm për Përgatitjen e pasqyrave financiare</i>, ose</p> <p>(b) Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të kërkojnë një ndryshim në paraqitje.</p>
17.	<p>Kur paraqitja ose klasifikimi i zërave në pasqyrat financiare ndryshohet, një njësi ekonomike do të riklasifikojë shumë krahasuese derisa riklasifikimi të jetë i pazbatueshëm. Kur shumë krahasuese riklasifikohen, njësi ekonomike duhet të japë informacionin shpjegues në vijim:</p> <p>(a) natyrën e riklasifikimit</p> <p>(b) shumën e çdo zëri ose klase të zërave të riklasifikuar</p> <p>(c) arsyen e riklasifikimit</p>
18.	<p>Nëse riklasifikimi i shumë krahasuese është i pazbatueshëm, një njësi ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese se përse riklasifikimi nuk është i mundur.</p>
	Informacioni krahasues
19.	<p>Përveç rastit kur Standardet Kombëtare të Kontabilitetit lejojnë ose kërkojnë ndryshe, një njësi ekonomike duhet të japë shpjegime mbi informacionin krahasues në lidhje me periudhën e mëparshme të krahasueshme për të gjithë shumëat e paraqitura në pasqyrat financiare të periudhës aktuale. Një njësi ekonomike do të përfshijë informacion krahasues për informacionin përshkruar në rastet kur këto shpjegime janë të rëndësishme për të kuptuar pasqyrat financiare të periudhës aktuale.</p>
	PËRMBAJTJA E PASQYRAVE FINANCIARE DHE KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR PËRGATITJEN E TYRE
20.	<p>Një set i plotë i pasqyrave financiare të një njësie ekonomike do të përfshijë të gjitha sa vijon:</p> <p>(a) pasqyrën e pozicionit financiar në datën e raportimit;</p> <p>(b) pasqyrën e performancës që përbëhet nga një pasqyrë e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe një pasqyrë e të ardhurave gjithpërfshirëse;</p> <p>(c) pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto për periudhën;</p> <p>(d) pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për periudhën;</p> <p>(e) shënimet shpjeguese, duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe shënime të tjera;</p>
21.	<p>Nëse një njësi ekonomike nuk ka zëra të të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse në ndonjë nga periudhat për të cilat janë paraqitur pasqyrat financiare, mund të paraqesë vetëm një pasqyrë të të ardhurave dhe shpenzimeve ku reshti i fundit emërtohet “fitim” ose “humbje”.</p>
22.	<p>Duke qenë se paragrafi 19 kërkon shumë krahasuese lidhur me periudhën e kaluar, për të gjitha shumëat e paraqitura në pasqyrat financiare, një grup i plotë i pasqyrave financiare nënkupton që një njësi ekonomike duhet të paraqesë si minimum, informacion për 2 vite, për secilën prej pasqyrave financiare të kërkuara dhe shënimet përkatëse të tyre.</p>
23.	<p>Në një set të plotë të pasqyrave financiare, një njësi ekonomike duhet t’i kushtojë të njëjtën rëndësi paraqitjes së çdo pasqyre financiare.</p>
24.	<p>Ky standard përshkruan kërkesa të përgjithshme, në lidhje me paraqitjen e pasqyrave financiare, si dhe natyrën e informacionit që duhet të jepet në shënimet shpjeguese të tyre. Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit mund të vendosë kërkesa shtesë, për sa u përket informacioneve që duhet të jepen në shënimet shpjeguese të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit.</p>
25.	<p>Në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9228, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, pasqyrat financiare përgatiten dhe paraqiten në lekë, duke treguar shkallën e rumbullakimit të shifrave (për shembull, në mijë lekë)</p>
26.	<p>Një njësi ekonomike do të identifikojë qartë secilën prej pasqyrave financiare dhe shënimet e tyre shpjeguese duke i dalluar ato nga çdo informacion tjetër jashtë këtij seti pasqyrash. Përveç kësaj, njësi ekonomike duhet të paraqesë informacionin e mëposhtëm dhe ta përsërisë atë kur është e nevojshme për të kuptuar informacionin e paraqitur:</p> <p>(a) emri i njësive ekonomike dhe çdo ndryshim në emrin e saj që nga fundi i periudhës së mëparshme;</p> <p>(b) nëse pasqyrat financiare mbulojnë njësi ekonomike individuale ose një grup të njësive ekonomike;</p> <p>(c) datën e përfundimit të periudhës raportuese dhe periudhën e mbuluar nga pasqyrat financiare;</p> <p>(d) monedhën e paraqitjes (lekë), siç përcaktohet në paragrafin 25 të këtij Standardi.</p> <p>(e) nivelin e rumbullakosjes, nëse ka, i përdorur në paraqitjen e shumëve në pasqyrat financiare.</p>
27.	<p>Një njësi ekonomike duhet të japë informacionin e mëposhtëm në shënimet shpjeguese: (a) vendbanimin dhe formën ligjore të njësive ekonomike, vendin e themelimit dhe adresën e zyrës së saj të regjistruar ose selinë e aktivitetit, nëse është e ndryshme nga zyra e saj e regjistruar;</p> <p>(b) një përshkrim të natyrës së operacioneve të njësive ekonomike dhe aktiviteteve kryesore të saj.</p>
28.	<p>Një njësi ekonomike duhet të paraqesë një set të plotë të pasqyrave financiare (duke përfshirë informacionin krahasues-shih paragrafin 19 të paktën çdo vit, siç kërkohet nga neni 14 i Ligjit nr. 9 228, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” nxjerrë në prill 2004. Kur fundi i periudhës raportuese të një njësie ekonomike ndryshon dhe pasqyrat financiare vjetore paraqiten për një periudhë më të gjatë ose më të shkurtër se sa një vit, njësi ekonomike duhet të japë informacionet</p>

	<p>shpjeguese në vijim:</p> <p>(a) faktin në vetvete;</p> <p>(b) arsyen për të përdorur një periudhë më të gjatë ose më të shkurtër;</p> <p>(c) faktin që shumat krahasuese të paraqitura në pasqyrat financiare (duke përfshirë edhe shënimet përkatëse) nuk janë plotësisht të krahasueshme.</p>
	PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
	Rregulla të Përgjithshme
29.	<p>Pasqyra e pozicionit financiar paraqet informacionin mbi pozicionin financiar të njësisë ekonomike në fund të periudhës raportuese. Pasqyra e pozicionit financiar ka tre përbërës kryesorë:</p> <p>(a) aktivet që kontrollojnë njësia ekonomike;</p> <p>(b) detyrimet që duhet të përmbushë njësia ekonomike;</p> <p>(c) kapitalin e pronarëve të njësive ekonomike.</p>
30.	Njësitë ekonomike (përveç njësive të përmendura në paragrafin 35) do të përdorin formatin e pasqyrës së pozicionit financiar të dhënë në Shtojcën 1 të këtij Standardi.
31.	Kategoritë e zërave në pasqyrën e pozicionit financiar (paraqitur me ngjyrë të zezë të theksuar në Shtojcën 1) duhet të respektohen, megjithëse mund të shtohen zëra të tjerë, nëse ata ndikojnë në përmirësimin e qartësisë dhe lexueshmërisë së pasqyrës së pozicionit financiar. Nënkategoritë e pasqyrës së pozicionit financiar mund të paraqiten në shënimet shpjeguese në vend që të paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar. Duke u bazuar në konceptin e materialitetit, zërat jomaterialë mund të paraqiten të grupuar.
32.	<p>Nënkategoritë e zërave në pasqyrën e pozicionit financiar (paraqitur me shkrim të pjerrët) mund të kombinohen dhe të tregohen në total_kur:</p> <p>(a) ato janë jo materiale në vlerë; ose</p> <p>(b) një kombinim i tillë jep një qartësi më të madhe, me kusht që zërat e kombinuar në këtë mënyrë të trajtohen veças në shënimet shpjeguese.</p>
33.	<p>Një njësi ekonomike me kapital aksionar jep informacion, ose në pasqyrën e pozicionit financiar ose në shënimet shpjeguese për çështjet në vijim :</p> <p>(a) për secilën klasë të kapitalit aksionar;</p> <p>(i) numrin e aksioneve të autorizuara;</p> <p>(ii) numrin e aksioneve të emetuara dhe të paguara plotësisht/të emetuara por jo të paguara plotësisht;</p> <p>(iii) vlerën nominale për aksion;</p> <p>(iv) rakordimin e numrit të aksioneve në qarkullim në fillim dhe në fund të periudhës;</p> <p>(v) të drejtat, preferencat dhe kufizimet referuar asaj klase, duke përfshirë kufizimet mbi shpërndarjen e dividendëve dhe ripagesat e kapitalit;</p> <p>(vi) aksionet e njësive ekonomike të mbajtura nga njësia ekonomike, nga filialet ose pjesëmarrjet e saj;</p> <p>(vii) aksionet e rezervuara për emetim sipas opsioneve dhe kontratave për shitjen e aksioneve, përfshirë afatet dhe shumat;</p> <p>(b) një përshkrim të rezervës brenda kapitalit neto.</p>
34.	Një njësi ekonomike pa kapital aksionar si p.sh, një ortakëri ose njësi ekonomike me përgjegjësi të kufizuar, duhet të japë informacion të njëjtë me atë që kërkohet nga paragrafi 33 (a), duke treguar ndryshimet gjatë periudhës në secilën kategori të kapitalit dhe të drejtat, preferencat dhe kufizimet që shoqërojnë çdo kategori të kapitalit neto.
	Formate të veçanta të pasqyrës së pozicionit financiar
35.	Një njësi ekonomike mund të përdorë një format të pasqyrës së pozicionit financiar të ndryshëm nga ai që është dhënë në shtojcën 1 të këtij Standardi, nëse ai format është i përshtatshëm për natyrën e veprimtarisë së shfrytëzimit të kësaj njësie (p.sh, njësitë e lizingut, organizatat jofitimprurëse dhe institucionet shtetërore).
36.	Nëse njësia ekonomike zgjedh një format tjetër të pasqyrës së pozicionit financiar nga ai i dhënë në shtojcën 1 të këtij Standardi, drejtuesit e kësaj njësie duhet të zgjedhin një format, i cili jep një pamje të vërtetë e të besueshme, referuar në nenin 9 të Ligjit nr. 9 228, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Institucionet shtetërore duhet të zbatojnë kërkesat e rregullave të përgjithshme të kontabilitetit publik.
	Dallimi mes zërave afatshkurtër dhe afatgjatë të aktiveve dhe detyrimeve
37.	Një njësi ekonomike do të paraqesë aktivet afatshkurtra dhe afatgjata, detyrimet afatshkurtra dhe afatgjata, si klasifikime të veçanta në pasqyrën e pozicionit financiar në përputhje me paragrafët 39 deri 45, përveç kur një prezantim në bazë të likuiditetit siguron informacion që është i besueshëm dhe më shumë i përshtatshëm.
38.	Në zgjedhjen e një formati të pasqyrës së pozicionit financiar, të ndryshëm nga ai i përshkruar në shtojcën 1 të Standardit, një njësi ekonomike mund ta quajë me vend mosklasifikimin e aktiveve dhe detyrimeve të saj si afatgjata dhe afatshkurtra (për shembull, në rastin e institucioneve financiare ku në përputhje me praktikën ndërkombëtare nuk bëhen dallime të tilla në pasqyrën e pozicionit financiar). Në këtë rast, njësia ekonomike duhet t’i paraqesë aktivet dhe detyrimet e saj në pasqyrën e pozicionit financiar sipas kriterit të likuiditetit.
	Aktivët afatshkurtra

39.	Një njësi ekonomike duhet të klasifikojë një aktiv si afatshkurtër kur: (a) ajo pret të realizojë aktivin, ose ka ndërmend ta shesë apo ta konsumojë atë, brenda ciklit normal të shfrytëzimit të njësisë ekonomike; (b) ajo e mban aktivin kryesisht për qëllime tregtimi; (c) ajo pret të realizojë aktivin brenda dymbëdhjetë muajve pas datës së raportimit;ose (d) aktivi është mjet monetar ose një ekuivalent i mjeteve monetare, nëse nuk është i kufizuar për t'u përdorur për shkëmbim ose të përdoret për të shlyer një detyrim për të paktën dymbëdhjetë muaj pas datës së raportimit.
40.	Një njësi ekonomike duhet të klasifikojë të gjitha aktivet e tjera si afatgjata. Kur cikli normal i njësisë ekonomike nuk është i identifikueshëm qartë, kohëzgjatja e tij supozohet të jetë dymbëdhjetë muaj.
Detyrimet afatshkurtra	
41.	Një njësi ekonomike duhet ta klasifikojë një detyrim si afatshkurtër kur: (a) ajo pret ta shlyejë detyrimin brenda ciklit normal të shfrytëzimit të njësisë ekonomike; (b) ajo e mban detyrimin kryesisht për qëllime tregtimi; (c) detyrimi do të shlyhet brenda dymbëdhjetë muajve pas datës së raportimit; ose (d) njësia ekonomike nuk ka një të drejtë të pakushtëzuar për të evituar shlyerjen e detyrimit për të paktën dymbëdhjetë muaj pas datës së raportimit.
42.	Njësi ekonomike duhet t'i klasifikojë të gjithë detyrimet e tjera si afatgjata.
43.	Një hua me afat maturimi deri në 12 muajsh, pas datës së pasqyrës së pozicionit financiar, do të paraqitet si një detyrim afatshkurtër, përveçse kur në datën e pasqyrës së pozicionit financiar njësi ekonomike ka mundësi ta shtyjë ose ta rifinancojë huanë (për shembull kur është lidhur një marrëveshje përkatëse me bankën ose kreditorin) dhe ka në plan ta përdorë këtë mundësi. Megjithatë, nëse njësi ekonomike planifikon ta shtyjë ose rifinancojë huanë, por nuk ka siguri mbi realizimin e këtij plani (për shembull nuk ka ndonjë marrëveshje për të shtyrë ose rifinancuar huanë), kjo hua do të paraqitet si afatshkurtër, edhe nëse pas datës së pasqyrës së pozicionit financiar huaja shtyhet ose rifinancohet.
44.	Kur një njësi ekonomike i ka shkelur kushtet e një marrëveshje të një huaje afatgjatë dhe si rezultat i kësaj huadhënësi ka të drejtë ta kërkojë menjëherë pagesën, atëherë kjo hua do të klasifikohet në pasqyrën e pozicionit financiar si afatshkurtër, edhe pse huadhënësi ka pranuar të mos e përdorë këtë të drejtë.
45.	Nëse, në datën e raportimit, një njësi ekonomike ka një marrëveshje detyruese shitjeje për aktive ose një grup të aktiveve dhe detyrimeve, njësi ekonomike duhet të japë informacionet shpjeguese si në vijim: (a) një përshkrim të aktivit ose grupit të aktiveve dhe detyrimeve; (b) një përshkrim të fakteve dhe rrethanave ose planit të shitjes; (c) vlerën kontabël të aktiveve ose, nëse nxjerrja jashtë përdorimit përfshin një grup të aktiveve dhe detyrimeve, vlerat kontabël të këtyre aktiveve dhe detyrimeve.
Kompensimi i aktiveve dhe detyrimeve (njohja në shumën neto)	
46.	Në përputhje me parimin e kompensimit të përshkruar në <i>paragrafët 64 dhe 65 të SKK 1, Parimet e përgjithshme për përgatitjen e pasqyrave financiare</i> , aktivet dhe detyrimet do të kompensohen në pasqyrën e pozicionit financiar, vetëm nëse njësi ekonomike ka të drejtë ligjore t'i kompensojë aktivet dhe detyrimet si dhe ekziston mundësia që ajo ta përdorë këtë të drejtë.
PASQYRA E PERFORMANCËS	
Rregulla të Përgjithshme	
47.	Një njësi ekonomike duhet të paraqesë performancën e saj për periudhën në (sipas shtojcës 2): - Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve; - Pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse
48.	Në pasqyrën e performancës duhet të përfshihen të gjithë zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura në një periudhë kontabël. Ky standard siguron trajtim të ndryshëm për rrethanat në vijim: (a) Efektet e korigjimeve të gabimeve dhe ndryshimet në politikat kontabël paraqiten si rregullime retrospektive të periudhave të mëparshme dhe jo si pjesë e fitimit ose humbjes në periudhën në të cilën ato lindin (shih paragrafët 98 deri 102 dhe 109 deri 115 të SKK 1 - <i>Parimet e Përgjithshme për Përgatitjen e Pasqyrave Financiare</i>); (b) Si pjesë e të ardhurave gjithëpërfshirëse, jashtë fitimit/ humbjes së vitit, njihen katër lloje të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse; (i) fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga përkthimi i pasqyrave financiare të një veprimtarie të huaj (shih SKK 12 - Efekti i ndryshimit të kurseve të këmbimit); (ii) fitimet që rrjedhin nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale në vlerë të drejtë sipas trajtimit alternativ të lejuar (shih SKK 5 - Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale); (iii) fitimet që rrjedhin nga rivlerësimi i aktiveve financiare të mbajtura për shitje (shih SKK 3 –Instrumentet Financiare); (iv) Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse nga pjesëmarrjet (shih SKK 9- Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta).
49.	Emërtimet e zërave duhet të respektohen, megjithëse mund të shtohen zëra të tjerë ose nënkategori të zërave, nëse ato

	ndikojnë në përmirësimin e qartësisë dhe lexueshmërisë së pasqyrës së performancës. Nënkatëgoritë e pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve mund të paraqiten në shënimet shpjeguese, në vend që ato të paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.
50.	Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve do të tregojë, si minimum, zërat që paraqesin shumat të cilat përbëjnë fitimin ose humbjen siç përcaktohet në një nga formatet e Shtojcës 2 të këtij standardi. Fitimi ose humbja do të jetë rreshti i fundit i kësaj pasqyre. Pasqyra e të ardhurave gjithpërfshirëse do të fillojë me fitimin ose humbjen si rresht të parë të saj dhe do të tregojë, si minimum, zërat që përcaktohen në Shtojcën 2 të këtij standardi.
	Kërkesat e zbatueshme
51.	Sipas këtij standardi, efektet e korigjimeve të gabimeve dhe ndryshimet në politikat kontabël paraqiten si rregullime retrospektive të periudhave të mëparshme dhe jo si pjesë e fitimit ose humbjes në periudhën në të cilën ato lindin (shih paragrafët 98-102 dhe 109-115 të SKK 1 – <i>Parimet e Përgjithshme për Përgatitjen e Pasqyrave Financiare</i>).
52.	Një njësi ekonomike nuk duhet t'i paraqesë apo t'i përshkruajë zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve si zëra të jashtëzakonshëm në pasqyrën e performancës ose në shënimet shpjeguese.
53.	Një njësi ekonomike duhet të paraqesë analizën e shpenzimeve duke përdorur një klasifikim të bazuar ose në natyrën e shpenzimeve (formati 1 në Shtojcën 2) ose në funksionin e shpenzimeve (formati 2 në Shtojcën 2) brenda njësisë ekonomike, duke zgjedhur atë format që siguron informacion më të besueshëm dhe më të përshtatshëm.
54.	Në formatin 1 të Shtojcës 2, shpenzimet e shfrytëzimit klasifikohen në bazë të natyrës së shpenzimeve (p.sh. lënda e parë dhe materiale të konsumueshme, shpenzime të personelit, shpenzimet e konsumit dhe amortizimit). Formatin 1 zbatohet përgjithësisht më lehtë, pasi ai nuk kërkon ndarjen e shpenzimeve ndërmjet funksioneve të ndryshme të njësisë ekonomike. Shoqëritë e vogla që nuk kanë nevojë të ndajnë shpenzimet sipas funksioneve, shpesh përdorin Formatin 1, por edhe shoqëri të mëdha në industri të ndryshme sipas praktikës ndërkombëtare zakonisht i përgatisin pasqyrat e të ardhurave dhe shpenzimeve bazuar në natyrën e shpenzimeve dhe jo në funksionin e tyre.
55.	Në formatin 2 të Shtojcës 2, shpenzimet e shfrytëzimit klasifikohen sipas funksionit të shpenzimeve të njësisë ekonomike (p.sh. kosto të shitjes, shpenzimet e shpërndarjes, shpenzimet administrative). Formatin 2 është më i vështirë për t'u zbatuar pasi duhet të merren vendime në lidhje me funksionet e shpenzimeve të shfrytëzimit me të cilat lidhen. Shpenzime të caktuara (p.sh. kostot e personelit) ndahen në mënyrë proporcionale ndërmjet funksioneve të ndryshme. Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, e paraqitur sipas formatit 2, ofron një informacion më të mirë të kostos së funksioneve të ndryshme në shoqëri për lexuesit e pasqyrës, në të njëjtën kohë shpërndarja e shpenzimeve sipas funksionit është subjektiv dhe pasqyrat e të ardhurave dhe shpenzimeve të njësisë të ndryshme të cilat përdorin Formatin 2, nuk mund të jenë të krahasueshme.
56.	Shtojca 2 e këtij standardi paraqet një numër minimal të zërave të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve. Përbërja e saktë e zërave të kësaj pasqyre varet nga aktivitetet e njësisë ekonomike dhe praktikës ndërkombëtare në fushën ku kjo njësi operon. Çdo njësi ekonomike duhet të japë në politikat dhe procedurat e saj kontabël përshkrime të hollësishme, se cilat të ardhura dhe shpenzime janë përfshirë në zërat përkatës të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve. Njësia ekonomike duhet t'i përmbahet këtij klasifikimi në mënyrë të vazhdueshme.
	Formate të veçanta të pasqyrës së performancës
57.	Në varësi të natyrës së aktivitetit ekonomik (për shembull, shoqëritë e lizingut, organizatat jofitimprurëse dhe institucionet shtetërore), njësia ekonomike raportuese mund të përdorë një format pasqyre performance të ndryshëm nga ai i dhënë në shtojcën 2 të këtij standardi.
58.	Zgjedhja e formatit të pasqyrës së performancës, të ndryshëm nga ata të dhënë në shtojcën 2 të këtij standardi, do të bëhet në përputhje me udhëzimet e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit që rregullon këto fusha, si dhe me praktikën ndërkombëtare në këtë fushë. Institucionet shtetërore duhet të përdorin kërkesat e rregullave të përgjithshme për kontabilitetin e sektorit publik.
	Kompensimi i të ardhurave dhe shpenzimeve (njohja në shumën neto)
59.	Të ardhurat dhe shpenzimet nuk do të kompensohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, me përjashtim të atyre të ardhurave dhe shpenzimeve që vijnë nga aktivitetet dytësore, apo që kanë ardhur nga një ose disa veprime të ngjashme, apo, që të marra veças nuk janë materiale.
60.	Në përgjithësi, të ardhurat dhe shpenzimet regjistrohen të ndara në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, pa i kompensuar me njëra-tjetrën. Të ardhurat dhe shpenzimet, që lidhen me aktivitetet dytësore, mund të kompensohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, nëse kjo jep një pamje më të vërtetë të natyrës së transaksioneve. Më poshtë jepen shembuj të situatave të kompensimit të të ardhurave me shpenzimet ku rezultati njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në shumën neto: (a) fitimet/humbjet, që vijnë nga shitja e aktiveve afatgjata materiale, raportohen në shumën neto (të ardhurat nga shitja e aktiveve afatgjata materiale minus vlerën kontabël neto të aktivitetit); (b) shpenzimet e qirasë të qiramarrësit kompensohen me të ardhurat nga qiraja që gjenerohen nga dhënia e mëtejshme me qira e të njëjtit aktiv (duke supozuar që qiraja nuk është aktivitet parësor i njësisë ekonomike); (c) fitimet/humbjet që vijnë nga ndryshimet e kursit të këmbimit raportohen neto në pasqyrën e të ardhurave dhe

	shpenzimeve; (d)fitimet/humbjet nga zbatimi i metodës së kapitalit raportohen neto në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve; (e)fitimet/humbjet nga shitja dhe rivlerësimi i investimeve financiare raportohen neto në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	
61.	Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare tregon hyrjet dhe daljet e mjeteve monetare në një njësi ekonomike gjatë periudhës kontabël.
62.	Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare jep informacion në lidhje me ndryshimet në mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare të një njësie ekonomike për një periudhë raportuese, duke treguar veças ndryshimet e aktiviteteve të shfrytëzimit, aktivitetet investuese dhe ato të financimit.
63.	Objektivi i pasqyrës së fluksit të mjeteve monetare është të përshkruajë mjetet monetare të gjeneruar e të përdorura nga njësia ekonomike, burimet e financimit dhe ndryshimet në pozicionin e mjeteve monetare si dhe ekuivalentëve të tyre në njësinë ekonomike. Informacioni mbi fluksin e mjeteve monetare përbën bazën për vlerësimin e mundësisë së njësisë ekonomike për të gjeneruar dhe përdorur mjetet monetare. Shtojca 3 e Standardit jep shembuj të pasqyrave të fluksit të mjeteve monetare të përgatitura sipas metodës direkte dhe indirekte.
64.	Ekuivalentet e mjeteve monetare janë investime afatshkurta, shumë likuide të cilat mbahen më shumë për të përmbushur angazhimet afatshkurtra në mjete monetare sesa për investime ose qëllime të tjera. Prandaj, një investim normalisht kualifikohet si ekuivalent i mjeteve monetare vetëm kur ai ka një maturim të shkurtër (përgjithësisht deri në 3 muaj). Overdraftet bankare konsiderohen normalisht si aktivitete financuese të ngjashme me huadhëniet. Megjithatë, në qoftë se ato janë të ripagueshme dhe formojnë një pjesë integrale të menaxhimit të mjeteve monetare të një njësie ekonomike, overdraftet bankare janë një komponent i mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të mjeteve monetare.
Fluksi i mjeteve monetare në monedhë të huaj	
65.	Një njësi ekonomike duhet të regjistrojë fluksin e mjeteve monetare që rrjedhin nga këmbimet në monedhë të huaj të monedhës funksionale të njësisë ekonomike duke zbatuar mbi shumën e monedhës së huaj kursin e këmbimit midis monedhës funksionale dhe monedhës së huaj në datën e këmbimit.
66.	Njësi ekonomike duhet të përkthejë fluksin e mjeteve monetare të një filiali të huaj në monedhën funksionale duke aplikuar kursin e këmbimit të monedhës së huaj në datën e përkthimit.
67.	Fitimet dhe humbjet e parealizuara që rrjedhin nga ndryshimet në kurset e këmbimit të monedhës së huaj nuk konsiderohen flukse të mjeteve monetare. Megjithatë, rakordimi i mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të mjeteve monetare në fillim dhe në fund të periudhës, efekti i ndryshimit të kursit të këmbimit në mjete monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare ose të mbajtura në monedhë të huaj, duhet të paraqiten në pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare . Prandaj, njësi ekonomike do të vlerësojë mjetet monetare dhe ekuivalentet e mbajtura gjatë periudhës raportuese (të tilla si shuma të monedhës së huaj të mbajtur dhe llogaritë bankare në monedhë të huaj) me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Njësi ekonomike duhet të paraqesë fitimin ose humbjen që rezulton e parealizuar, veçmas nga aktivitetet e shfrytëzimit, investimit dhe financimit .
Interesi dhe dividendët	
68.	Një njësi ekonomike duhet të paraqesë veçmas fluksin e mjeteve monetare nga interesi dhe dividendët e marrë dhe të paguar. Njësi ekonomike duhet të klasifikojë fluksin e mjeteve monetare në vazhdimësi nga periudha në periudhë si të aktiviteteve të shfrytëzimit, investimit ose financimit.
69.	Një njësi ekonomike mund të klasifikojë interesin e marrë/paguar dhe dividendin e marrë si flukse të mjeteve monetare të shfrytëzimit për shkak të përfshirjes së tyre në fitim ose humbje. Ndryshe, njësi ekonomike mund të klasifikojë interesin e marrë/paguar dhe dividendin e marrë si flukse të mjeteve monetare të financimit dhe të investimit respektivisht, për shkak se ato janë kosto të marrjes së burimeve financiare ose të kthimit të investimeve.
70.	Një njësi ekonomike mund t'i klasifikojë dividendët e paguar si fluks të mjeteve monetare të financimit, sepse ata përbëjnë koston e marrjes së burimeve financiare. Ndryshe, njësi ekonomike mund t'i klasifikojë dividendët e paguar si komponentë të flukseve të mjeteve monetare nga aktivitetet e shfrytëzimit sepse ato paguhet nga flukse të mjeteve monetare të shfrytëzimit.
Tatimi mbi Fitimin	
71.	Një njësi ekonomike duhet të paraqesë veçmas fluksin monetare që vijnë nga tatim fitimi dhe do t'i klasifikojë ato si fluksin e mjeteve monetare nga aktivitetet e shfrytëzimit përveç nëse ato mund të identifikohen në mënyrë specifike me aktivitetet e financimit dhe ato investuese. Kur fluksin monetare tatimore ndahen në më shumë se një klasë të aktivitetit, njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për shumën totale të tatimeve të paguara.
Aktivitetet e Shfrytëzimit	
72.	Aktivitetet e shfrytëzimit janë burimi kryesor i gjenerimit të të ardhurave të njësisë ekonomike. Prandaj, fluksin e mjeteve monetare nga aktivitetet e shfrytëzimit zakonisht rezultojnë nga transaksionet dhe ngjarjet e tjera apo rrethanat që përcaktojnë fitimin ose humbjen. Burimet kryesore të flukseve të mjeteve monetare nga aktivitetet e shfrytëzimit përfshijnë: (a) arkëtimet e mjeteve monetare nga shitja e mallrave dhe ofrimi i shërbimeve;

	<p>(b) arkëtimet e mjeteve monetare nga honoraret, tarifat, komisionet dhe të ardhurat e tjera;</p> <p>(c) pagesat e mjeteve monetare për mallra dhe shërbime;</p> <p>(d) pagesat e mjeteve monetare për punonjësit;</p> <p>(e) pagesat e mjeteve monetare ose rifinancimet e tatimit mbi fitimin, derisa të identifikohen specifikisht në aktivitetet financuese dhe investuese;</p> <p>(f) arkëtimet dhe pagesat nga investimet, kreditë dhe kontratat e tjera që kanë të bëjnë ose të mbajtura për qëllime tregtare, të cilat janë të ngjashme me inventarin e blerë për rishitje. Disa transaksione, të tilla si shitja e një pjese të makinerive nga ana e një njësie ekonomike prodhuese, mund të sjellin një fitim/ humbje në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Megjithatë, flukset e mjeteve monetare që lidhen me transaksione të tilla janë flukse monetare nga aktivitetet investuese.</p>
	Raportimi i flukseve të mjeteve monetare nga aktivitetet e shfrytëzimit
73.	<p>Një njësi ekonomike duhet të paraqesë flukset e mjeteve monetare nga aktivitetet e shfrytëzimit duke përdorur ose:</p> <p>(a) metodën direkte, ku shpjegohen klasat kryesore të arkëtimeve/ pagesave bruto në parë;</p> <p>(b) metodën indirekte, ku fitimi/humbja e vitit rregullohet për efekte të transaksioneve jo monetare (çdo shtyrje ose rritje e arkëtimeve ose pagesave të shkuara ose të ardhshme dhe zëra të të ardhurave ose shpenzimeve lidhur me investimin ose financimin e fluksit të mjeteve monetare).</p>
	Metoda Direkte
74.	<p>Sipas metodës direkte, fluksi neto i mjeteve monetare nga aktivitetet e shfrytëzimit paraqitet në dhënien e informacioneve shpjeguese rreth klasave kryesore të arkëtimeve/pagesave bruto siç identifikohet në paragrafin 72. Një informacion i tillë mund të merret ose:</p> <p>(a) nga regjistrat e kontabilitetit të njësisë ekonomike; ose</p> <p>(b) duke rregulluar shitjet, koston e shitjeve dhe zëra të tjerë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve;</p> <p>(i) ndryshimet gjatë periudhës në inventarët dhe të drejtat e arkëtueshme dhe detyrime të pagueshme të shfrytëzimit;</p> <p>(ii) zëra të tjerë jo monetarë; dhe</p> <p>(iii) zëra të tjerë për të cilët efektet e mjeteve monetare janë flukse të mjeteve monetare investuese ose të financimit.</p>
	Metoda Indirekte
75.	<p>Sipas metodës indirekte, fluksi neto i mjeteve monetare nga aktiviteti i shfrytëzimit përcaktohet duke rregulluar fitimin/humbjen e vitit për efektet e:</p> <p>(a) ndryshimeve gjatë periudhës në inventarët dhe të drejtat e arkëtueshme dhe detyrime të pagueshme të shfrytëzimit;</p> <p>(b) zërave jo monetarë të tillë si shpenzimet financiare jomonetarë, shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar, shpenzime konsumi dhe amortizimi, zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale; dhe</p> <p>(c) të gjithë zërat e tjerë për të cilët efektet e mjeteve monetare lidhen me investimin ose financimin.</p>
	Fluksi i mjeteve monetare nga aktiviteti investues
76.	<p>Aktivitetet investuese janë blerja dhe shitja e aktiveve afatgjata dhe investime të tjera që nuk përfshihen në ekuivalentë të mjeteve monetare. Flukset kryesore të mjeteve monetare që rrjedhin nga aktivitetet investuese përfshijnë:</p> <p>(a) pagesat për blerjen e aktiveve afatgjata materiale (përfshirë aktivet afatgjata materiale të vetëndërtuara), aktiveve jo-materiale dhe të tjera aktiveve afatgjata;</p> <p>(b) arkëtimet nga shitja e aktiveve afatgjata, aktiveve jo-materiale dhe të tjera aktive afatgjata;</p> <p>(c) pagesat në mjete monetare për blerjen e instrumenteve të kapitalit neto ose të borxhit të njësive të tjera ekonomike dhe interesave në sipërmarrjet e përbashkëta (përveç pagesave për ato instrumente të klasifikuara si ekuivalentë të mjeteve monetare ose të mbajtura për tregtim ose shitje);</p> <p>(d) arkëtimet për shitjen e instrumenteve të kapitalit neto ose të borxhit të njësive të tjera ekonomike dhe interesave në sipërmarrjet e përbashkëta (përveç arkëtimeve për ato instrumente të klasifikuara si ekuivalentë të mjeteve monetare ose të mbajtura për tregtim ose shitje);</p> <p>(e) paragimimet dhe huatë e dhëna palëve të tjera;</p> <p>(f) arkëtimet e mjeteve monetare të paragimeve dhe huave të dhëna palëve të tjera.</p>
	Fluksi i mjeteve monetare nga aktiviteti i financimit
77.	<p>Aktivitetet financuese janë aktivitetet që rezultojnë në ndryshime në madhësinë dhe përbërjen e kapitalit të kontribuar dhe huamarrjet e njësive ekonomike. Shembuj të fluksit të mjeteve monetare që rrjedh nga aktiviteti i financimit janë:</p> <p>(a) arkëtimi i mjeteve monetare nga emetimi i aksioneve ose instrumenteve të tjerë të kapitalit neto;</p> <p>(b) pagesa në mjete monetare për blerjen e aksioneve të veta;</p> <p>(c) arkëtimi i mjeteve monetare nga marrja e huave, afatshkurtra apo afatgjata, dëftesave dhe kolateralit;</p> <p>(d) pagesa e mjeteve monetare të huave dhe koston e huasë;</p> <p>(e) pagesat në mjete monetare të qirasë financiare.</p>
	Raportimi i fluksit të mjeteve monetare nga aktivitetet investuese dhe financuese
78.	<p>Një njësi ekonomike duhet të paraqesë veçmas klasa të mëdha të arkëtimeve /pagesave bruto të mjeteve monetare që rrjedhin nga aktivitetet investuese dhe financuese. Shuma e fluksit të mjeteve monetare që rrjedh nga blerjet dhe nga shitjet e filialeve ose njësive të tjera të biznesit duhet të paraqitet veçmas dhe të klasifikohet si aktivitet investues.</p>

	Transaksionet jomonetare
79.	Një njësi ekonomike duhet të përjashtojë nga pasqyra e fluksit të mjeteve monetare,(aktiviteti investues dhe financues), transaksionet që nuk kërkojnë përdorimin e mjeteve monetare ose ekuivalentëve të mjeteve monetare. Një njësi ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese për transaksione të tilla diku tjetër në pasqyrat financiare duke siguruar të gjitha informacionet përkatëse në lidhje me këto aktivitete.
80.	Shumë aktivitete investimi dhe financimi nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në fluksin e mjeteve monetare, ndonëse ato ndikojnë në strukturën e kapitalit dhe aktivitetin e njësisë ekonomike. Përjashtimi i transaksioneve jomonetare nga pasqyra e fluksit të mjeteve monetare është në përputhje me objektivin e kësaj pasqyre, pasi këto transaksione nuk shoqërohen me flukse hyrëse ose dalëse të mjeteve monetare. Shembuj të veprimeve jomonetare janë për shembull, blerja e aktiveve nëpërmjet një qiraje financiare si dhe konvertimi i një borxhi në kapital.
	Përbërësit e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të mjeteve monetare
81.	Një njësi ekonomike duhet të paraqesë komponentët e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të mjeteve monetare, shumat e të cilave duhet të rakordojnë midis pasqyrës së fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrës së pozicionit financiar. Megjithatë, një njësi ekonomike nuk i kërkohet të paraqesë këtë rakordim në qoftë se shumata e mjeteve monetare dhe e ekuivalentëve të mjeteve monetare të paraqitura në pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare është e njëjtë me shumën e përshkruar në mënyrë të ngjashme në pasqyrën e pozicionit financiar.
	Shënime të tjera shpjeguese lidhur me mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare
82.	Një njësi ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese, së bashku me një koment nga drejtuesit e saj, mbi shumën e mjeteve të konsiderueshme monetare dhe të gjendjeve të mbajtura nga njësi ekonomike, që nuk janë në përdorim nga njësi ekonomike. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e mbajtura nga njësi ekonomike mund të mos jenë të disponueshme për përdorim nga njësi ekonomike për shkak, midis arsyeve të tjera, edhe të kontrolleve të këmbimeve valutore apo kufizimeve ligjore.
	PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL
83.	Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto paraqet fitimin e një njësie ekonomike ose humbjen për një periudhë të raportimit, zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura në pasqyrën e performancës për periudhën, efektet e ndryshimeve në politikën kontabël dhe korrigjimet e gabimeve të njohura në periudhën dhe shumata e investimeve, dividendët dhe shpërndarjet e tjera ndaj investitorëve të kapitalit neto gjatë periudhës.
84.	Një njësi ekonomike duhet të paraqesë një pasqyrë të ndryshimeve në kapitalin neto duke treguar: (a) të ardhurat totale gjithëpërfshirëse për periudhën, duke treguar veçmas shumata totale që i atribuohen pronarëve të njësisë ekonomike mëmë dhe interesave jokontrolluese; (b) për çdo përbërës të kapitalit neto, efektet e zbatimit retrospektiv ose riparimit retrospektiv të njohur në përputhje me paragrafët 98 – 102 dhe 109-115 të SKK1 – <i>Parimet e Përgjithshme për Përgatitjen e Pasqyrave Financiare</i> ; (c) për çdo përbërës të kapitalit neto, një rakordim mes vlerës kontabël në fillim dhe në fund të periudhës, duke shpjeguar veçmas ndryshimet që rezultojnë nga: (i) fitimi/humbja e vitit; (ii) çdo zë i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse; (iii) shumata e investimeve, dividendët dhe shpërndarjet e tjera ndaj pronarëve, duke shpjeguar veçmas emetimin e aksioneve, transaksionet me aksionet e veta, dhe ndryshimet në interesat e pronësisë në filiale që nuk rezultojnë në një humbje të kontrollit.
85.	Formati i dhënë në shtojcën 4 të këtij standardi rekomandohet për përgatitjen e pasqyrës së ndryshimeve në kapital.
	SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE
86.	Ky seksion përcakton informacionin bazë themelor që duhet të paraqitet në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare dhe mënyrën e paraqitjes së tij. Shënimet përmbajnë informacion përveç atij që paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto dhe pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare. Shënimet japin përshkrime me fjalë ose zbërthime të zërave të paraqitura në këto pasqyra dhe informacione rreth zërave që nuk kualifikohen për njohje në këto pasqyra. Përveç kërkesave të këtij standardi çdo standard tjetër i SKK-ve kërkon dhënie informacionesh shpjeguese përkatëse.
	Struktura e shënimeve shpjeguese
87.	Shënimet shpjeguese japin: (a) informacione në lidhje me bazën e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe politikën specifike kontabël të përdorura; (b) informacion shpjegues të kërkuar nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit i cili nuk është paraqitur diku tjetër në pasqyrat financiare; dhe (c) informacion që nuk është paraqitur diku tjetër në pasqyrat financiare por është i nevojshëm për të kuptuar ndonjë prej tyre.
88.	Një njësi ekonomike normalisht i paraqet shënimet shpjeguese në rendin e mëposhtëm: (a) një deklaratë që pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; (b) një përmbledhje të politikave kontabël të rëndësishme të zbatuara;

	(c) informacion mbështetës për zërat e paraqitur në pasqyrat financiare, në rendin në të cilin paraqitet çdo pasqyrë dhe zë përkatës; (d) shënime të tjera shpjeguese.	
	Dhënia e informacioneve shpjeguese për politikat kontabël	
89.	Një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues në vijim në përmbledhjen e politikave të rëndësishme kontabël: (a) baza e matjes (ose bazat) të përdorura në përgatitjen e pasqyrave financiare; (b) politikat e tjera kontabël të përdorura, të rëndësishme për kuptimin e pasqyrave financiare.	
	Informacion në lidhje me burimet kryesore të pasigurisë së vlerësimit	
90.	Një njësi ekonomike duhet të japë informacione në shënimet shpjeguese rreth supozimeve kyçe lidhur me të ardhmen, dhe burime të tjera kryesore të pasigurisë së vlerësimit në datën e raportimit, të cilat ka shumë mundësi të sjellin një rregullim material në vlerat kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Përsa i përket këtyre aktiveve dhe detyrimeve, shënimet shpjeguese duhet të përfshijnë detajet e: (a) natyrës së tyre; (b) vlerës së tyre kontabël në fund të periudhës raportuese.	
	Shpjegime mbi palët e lidhura	
91.	Njësitë konsiderohen si të lidhura, nëse njëra palë ose kontrollon palën tjetër, ose ka një ndikim të ndjeshëm mbi palën tjetër. Ndikimi i ndjeshëm ekziston kur ajo lidhet me vendimet financiare dhe ato të shfrytëzimit. Palët janë të lidhura edhe kur ato janë nën kontrollin e përbashkët të një njësie tjetër. Ekzistenca e kontrollit, kontrollit të përbashkët ose ndikimit të ndjeshëm mund të ndikojnë mbi mënyrën se si të dyja palët hyjnë në aktivitete biznesi me njëra-tjetrën. Prandaj, për t'i kuptuar sa më mirë pasqyrat financiare të një njësie ekonomike, duhet të kuptohen mirë marrëdhëniet dhe kushtet, në të cilat palët e lidhura hyjnë në aktivitete biznesi me njëra-tjetrën. Shembuj të palëve të lidhura përfshijnë: (a) njësia mëmë (dhe personat që kontrollojnë ose kanë ndikim të ndjeshëm mbi njësinë mëmë); (b) njësitë e kontrolluara; (c) pjesëmarrjet; (d) sipërmarrje të tjera të të njëjtit grup konsolidimi (për shembull, njësitë e kontrolluara simotra); (e) drejtuesit, anëtarët e organit mbikëqyrës si dhe aksionarët që zotërojnë një pjesë të konsiderueshme të aksioneve, me përjashtim të atyre rasteve kur këta persona nuk e kanë mundësinë praktike të ushtrojnë influencë të ndjeshme mbi vendimet ekonomike të njësisë ekonomike raportuese; (f) të afërmit e ngushtë të personave të përmendur në pikën (e) (përfshirë këtu personat e afërt dhe fëmijët) si dhe njësitë ekonomike që janë nën kontrollin ose ndikimin e tyre.	
92.	Në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare duhet të paraqitet informacioni i mëposhtëm mbi palët e lidhura dhe veprimet me to: (a) emri i njësisë (për shembull, njësia mëmë ose një person që zotëron shumicën e aksioneve) që kontrollon njësinë ekonomike, si dhe emri i njësisë mëmë që kontrollon të gjithë grupin; (b) llojin dhe volumin e transaksioneve me palët e lidhura gjatë vitit si dhe shpërblimin total të dhënë stafit drejtues dhe anëtarëve të organit mbikëqyrës; (c) gjendjen e llogarive ku janë përfshirë transaksionet me palët e lidhura, në datën e pasqyrës së pozicionit financiar; (d) politikat e çmimeve të aplikuar në transaksionet me palët e lidhura.	
93.	Një informacion mbi transaksione të veçanta me palët e lidhura duhet të jepet, të paktën për grupet e palëve të lidhura, të përmendura në paragrafin 91.	
94.	Transaksionet me njësitë e kontrolluara, që eliminohen gjatë konsolidimit, nuk duhet të shpjegohen në pasqyrat financiare të konsoliduara.	
	DATA DHE RREGULLAT E ZBATIMIT TË STANDARDEVE	
95.	Ky Standard do të zbatohet në pasqyrat financiare që mbulojnë periudha kontabël, që fillojnë më ose pas datës 01.01.2015. Ky Standard duhet të zbatohet në mënyrë prospektive nga data 1 Janar 2015.	
	KRAHASIMI ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR PËR NJËSITË EKONOMIKE TË VOGLA DHE TË MESME (SNRF për NVM)	
96.	Kjo tabelë tregon se përmbajtjet e këtij Standardi Kombëtar të Kontabilitetit dhe seksionet përkatëse të SNRF për NVM-të (2009) korrespondojnë me njëra tjetrën. Paragrafët trajtohen si korresponduese, nëse ato trajtojnë në përgjithësi të njëjtën çështje edhe pse udhëzimi mund të jetë i ndryshëm.	
	Paragrafët e SKK 2	
	Paragrafët e SNRF për NVM botuar në korrik 2009	
	Paragrafi 1	Asnjë
	Paragrafi 2	Asnjë
	Paragrafi 3	Asnjë
	Paragrafi 4	Asnjë
	Paragrafi 5	Asnjë
	Paragrafi 6	SEK 3.16

Paragrafi 7	SEK 3.15
Paragrafi 8	SEK 3.2
Paragrafi 9	SEK 3.3
Paragrafi 10	SEK 3.4
Paragrafi 11	SEK 3.5
Paragrafi 12	SEK 3.6
Paragrafi 13	SEK 3.8
Paragrafi 14	SEK 3.9
Paragrafi 15	SEK 3.9
Paragrafi 16	SEK 3.11
Paragrafi 17	SEK 3.12
Paragrafi 18	SEK 3.13
Paragrafi 19	SEK 3.14
Paragrafi 20	SEK 3.17
Paragrafi 21	SEK 3.19
Paragrafi 22	SEK 3.20
Paragrafi 23	SEK 3.21
Paragrafi 24	Asnjë
Paragrafi 25	Asnjë
Paragrafi 26	SEK 3.23
Paragrafi 27	SEK 3.24
Paragrafi 28	SEK 3.10
Paragrafi 29	SEK 4.2
Paragrafi 30	Asnjë
Paragrafi 31	Asnjë
Paragrafi 32	Asnjë
Paragrafi 33	SEK 4.12
Paragrafi 34	SEK 4.13
Paragrafi 35	Asnjë
Paragrafi 36	Asnjë
Paragrafi 37	SEK 4.4
Paragrafi 38	Asnjë
Paragrafi 39	SEK 4.5
Paragrafi 40	SEK 4.6
Paragrafi 41	SEK 4.7
Paragrafi 42	SEK 4.8
Paragrafi 43	Asnjë
Paragrafi 44	Asnjë
Paragrafi 45	SEK 4.14
Paragrafi 46	Asnjë
Paragrafi 47	SEK 5.2
Paragrafi 48	SEK 5.4
Paragrafi 49	SEK 5.5
Paragrafi 50	SEK 5.7
Paragrafi 51	SEK 5.8
Paragrafi 52	SEK 5.10
Paragrafi 53	SEK 5.11
Paragrafi 54	SEK 5.11
Paragrafi 55	SEK 5.11
Paragrafi 56	Asnjë
Paragrafi 57	Asnjë
Paragrafi 58	Asnjë
Paragrafi 59	Asnjë
Paragrafi 60	Asnjë
Paragrafi 61	Asnjë

	Paragrafi 62	SEK 7.1
	Paragrafi 63	Asnjë
	Paragrafi 64	SEK 7.2
	Paragrafi 65	SEK 7.11
	Paragrafi 66	SEK 7.12
	Paragrafi 67	SEK 7.13
	Paragrafi 68	SEK 7.14
	Paragrafi 69	SEK 7.15
	Paragrafi 70	SEK 7.16
	Paragrafi 71	SEK 7.17
	Paragrafi 72	SEK 7.4
	Paragrafi 73	SEK 7.7
	Paragrafi 74	SEK 7.9
	Paragrafi 75	SEK 7.8
	Paragrafi 76	SEK 7.5
	Paragrafi 77	SEK 7.6
	Paragrafi 78	SEK 7.10
	Paragrafi 79	SEK 7.18
	Paragrafi 80	SEK 7.19
	Paragrafi 81	SEK 7.20
	Paragrafi 82	SEK 7.21
	Paragrafi 83	SEK 6.2
	Paragrafi 84	SEK 6.3
	Paragrafi 85	Asnjë
	Paragrafi 86	SEK 8.1
	Paragrafi 87	SEK 8.2
	Paragrafi 88	SEK 8.4
	Paragrafi 89	SEK 8.5
	Paragrafi 90	SEK 8.7
	Paragrafi 91	Asnjë
	Paragrafi 92	Asnjë
	Paragrafi 93	Asnjë
	Paragrafi 94	Asnjë
	Paragrafi 95	Asnjë
	Paragrafi 96	Asnjë